



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURES
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1212 Prot.

Tiranë, më 03.10 2018

VENDIM Nr. 174, datë 25.09.2018

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"*, Neni 134, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 8, datë 25.09.2018, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të *projektit "HEC "AMME" përroi i Dolistit dhe lumi Kalivaçit, Bashkia Pogradec"*-subjekti "AMME" sh.p.k., realizuar nga individët e licencuar në arkeologji Z. Neritan Ceka dhe Z. Skënder Muçaj,

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të *projektit "HEC "AMME" përroi i Dolistit dhe lumi Kalivaçit, Bashkia Pogradec"*-subjekti "AMME" sh.p.k., realizuar nga individët e licencuar në arkeologji Z. Neritan Ceka dhe Z. Skënder Muçaj.
2. Subjekti "AMME" sh.p.k., duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin "HEC "AMME" përroi i Dolistit dhe lumi Kalivaçit, Bashkia Pogradec", si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë subjekt.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë
Tel: ++355 04 45 35 855
email: sekretaria.kka@asha.gov.al
Website: asha.gov.al

5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al